



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 gusht 2019
Nr. ref.:RK 1420/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI184/18

Parashtrues

Illir Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2783/18, të 18 shtatorit 2018

GJYKATA KUSHTESTUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Illir Gashi, nga Mitrovica (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Adem Vokshi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Ac.nr. 2783/18] të 18 shtatorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës në lidhje me Aktvendimin [E.nr.557/12] e 15 janarit 2016 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 47 [Kërkesat individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu Krasniqi.
7. Më 13 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës së Apelit të Kosovës.
8. Më 23 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte një borxh ndaj Komunës së Mitrovicës për pagesë në emër të tarifës për rregullimin e tokës ndërtimore, e lidhur me ndërtimin e ndërtesës afariste banesore, në shumë prej 10.000,00 Euro. Në bazë të konkluzionit të Komunës së Mitrovicës (Pr. Nr. 08-20/12 i 11 majit 2012), parashtruesi ishte i obliguar që ta përmbushte pagesën e tarifës së lartcekur në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit. Pasi që parashtruesi dështoi që ta paguante detyrimin e lartcekur brenda afatit, Komuna e Mitrovicës iu drejtua Gjykatës Themelore

- në Mitrovicë me propozim për lejim të ekzekutimit të pagesës në shumë prej 10.000,00 Euro.
10. Më 18 shtator 2012, atëherë Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktvendim E. Nr. 557/12) kishte lejuar përmbarimin e konkluzionit të lartpërmendur të Komunës së Mitrovicës.
 11. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar prapësim ndaj vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Mitrovicë.
 12. Më 15 janar 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendim E.nr.557/12) refuzoi prapësimin e debitorit kundër Aktvendimit të lartpërmendur për lejimin e përmbarimit. Gjykata Themelore arsyetoi se prapësimi është i pabazuar sepse nuk është përmbushur asnjëri nga shkaqet e parapara në nenin 71 të Ligjit nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbarimore.
 13. Më 19 prill 2018, parashtruesi paraqiti ankesë kundër Aktvendimit E.nr.557/12 të 15 janarit 2016, duke pretenduar shkelje të dispozitave kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i goditur të priset dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.
 14. Më 11 maj 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendim E.nr.557/2012) ankesën e parashtruesit e hodhi si të paafatshme. Gjykata Themelore shpjegoi se afati për ankim është shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të aktvendimit. Gjykata Themelore më tej shtoi se referenti i përmbarimeve i asaj gjykate iu ka dorëzuar aktvendimin e goditur anëtarëve të familjes së parashtruesit me 22 janar 2016, në vendin ku punon parashtruesi, ndërsa parashtruesi kishte paraqitur ankesën e tij më 19 prill 2018.
 15. Me 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke goditur aktvendimin e lartcekur dhe pretendoi shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se aktvendimi i ankimuar nuk i është dorëzuar asnjëherë, andaj edhe ankesa nuk mund të refuzohet si e paafatshme nga Gjykata Themelore.
 16. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendoi se Aktvendimin [E.nr. 557/12] e goditur të Gjykatës Themelore të 15 janarit 2016 e ka pranuar më 17 prill 2018 pas iu kishte drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës propozoi që aktvendimi i kontestuar të priset dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.
 17. Më 18 shtator 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.2783/18] e aprovoi: (i) si të themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktvendimit [E.nr.557/123] të Gjykatës Themelore të 11 majit 2018; dhe, (ii) e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktvendimit [E.nr.557/12] të Gjykatës Themelore të 15 janarit 2016.
 18. Gjykata e Apelit konstatoi se Aktvendimi [E.nr.557/12] i 11 majit 2018 karakterizohej me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, i lidhur me nenin 107, paragrafi 1 të LPK-së pasi që

aktvendimi i goditur është dashur t'i dorëzohet përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit shpjegoi: *“Në bazë të nenit 107, paragrafi 1 të LPK-se, përcaktohet se kur palën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor apo me prokurë, shkresa i dorëzohet përfaqësuesit ligjor, përkatësisht përfaqësuesit me prokurë, në rastin konkret Gjykata Themelore është dashur që Aktvendimin [E.nr. 557/12] të 15 Janar 2016 t'ia dorëzoj përfaqësuesit me prokurë.”*
20. Gjykata e Apelit konstatoi se Aktvendimi [E.nr.557/12] i 15 janarit 2016 është i drejtë dhe nuk karakterizohet me shkelje thelbësore të dispozitave të Procedurës Kontestimore.
21. Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se konkluzioni i Komunës së Mitrovicës në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi nuk i është dorëzuar asnjëherë, është pretendimi i pabazuar sepse në shkresat e lëndës ekziston fletëdorëzimi [nr. 08-20/12] i 15 majit 2012 që dëshmon se konkluzioni i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës në zyrë në prezencë të punëtorëve. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit konstatoi se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të vërtetohet dhe ankesa e parashtruesit të refuzohet si e pathemeltë.
22. Për sa i përket konkluzionit të Komunës së Mitrovicës (Pr. nr. 08-20/12 i 11 majit 2012) i cili ishte vërtetuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendim E. nr 557/12 i 15 janarit 2016), Gjykata e Apelit arsyetoi: *“Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit përmbarues, organi përmbarues e cakton përmbarimin vetëm në bazë të titullit përmbarues sipas nenit 23, e në rastin konkret titull përmbarues është konkluzioni i lëshuar nga Komuna e Mitrovicës-Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, nr. prot. 08-20/12 të datës 11.05.2012 [...] Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike [...] e që në rastin konkret kemi të bëjmë me konkluzion siç përcaktohet me dispozita ligjore.”*
23. Më 31 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale pasi që ai pretendonte se nuk kishte pranuar konkluzionin e Komunës së Mitrovicës.
24. Më 14 nëntor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë me arsyetimin se nuk ishin plotësuar kushtet sipas nenit 247.1 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe njoftoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të shkresave të lëndës, respektivisht fletëdorëzimit, rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte pranuar konkluzionin në zyrën e tij në prezencë të punëtorëve.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [Ac.nr.2783/18] i 18 shtatorit 2018 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë [E.nr.557/12] i 15 shkurtit 2016 shkelin të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
26. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se konkluzioni i lëshuar nga Komuna e Mitrovicës në bazë të të cilit Gjykata Themelore kishte lejuar përmbarimin nuk i është dorëzuar asnjëherë dhe në këtë mënyrë atij i është pamundësuar ushtrimi i mjetit juridik.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Themelore [E.nr.557/12] i 15 janarit 2016 nuk i është dorëzuar të autorizuarit të tij.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Për këtë propozuesi konsideron se procesi i zhvilluar nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe ai i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nuk janë procese të rregullta me që është cenuar siguria juridike e parashtruesit të kërkesës kur të njëjtit nuk i është dhënë mundësia e njoftimit me konkluzionin e palës kundërshtare edhe pse kjo çështje është e garantuar edhe me Kushtetutën e Kosovës -neni 31 i Kushtetutës ku behët fjalë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për një të drejtë të tillë propozuesit i është garantuar edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.”*
29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i shpall të pavlefshme aktvendimet e kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Dispozitat ligjore relevante:

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 71

Shkaqet e prapësimit

Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse:

1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë;

1.2. dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik;

1.3. palët, përmes dokumentit publik ose dokumentit të certifikuar në pajtim me ligjin, të hartuar pas krijimit të dokumentit përmbarues, janë

pajtuar që të mos e kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues për një periudhë kohore të kufizuar ose përgjithmonë;

1.4. ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkojë përmbartimi;

1.5. përmbartimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbartimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësit për kryerjen e përmbartimit janë të kufizuara;

1.6. kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit;

1.7. kushti i përcaktuar në dokumentin përmbartues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj;

1.8. kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdie gjyqësore ose një ujdie administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;

1.9. realizimi i kredisë është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër, në mënyrë të përhershme ose për një periudhë të kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk mund ta bënte të njohur në procedurë në të cilën është nxjerr vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdie në Gjykatë ose në organin administrativ;

1.10. kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve;

1.11. Gjykata që ka marr vendimin për përmbartim nuk është kompetente;

1.12. përmbartuesi që ka lëshuar urdhrin për përmbartim nuk është kompetent.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata se pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Ac.nr.2783/18] e 18 shtatorit 2018 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

35. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
36. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se nuk i është dorëzuar konkluzioni i Komunës së Mitrovicës dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore i 15 janarit 2016.
37. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht thekson që pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
38. Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet këtij parimi (shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për Papranueshmërisë i 13 qershorit 2018, paragrafi 31)
39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se: (i) Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk ia kishte dorëzuar Aktvendimin [E.nr.557/12] e 15 janarit 2016 të autorizuarit të parashtruesit të kërkesës në mënyrë që parashtruesi të kishte mundësi ta kontestonte atë në afat; dhe, (ii) se konkluzioni i Komunës së Mitrovicës Pr. nr. 08-20/12 i 11 majit 2012 nuk i është dorëzuar atij në mënyrë që të mund të ushtronte mjet efektiv juridik.
40. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit u është përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës duke anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore të 15 majit 2018 pasi që aktvendimi nuk i ishte dorëzuar përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës, por vetëm anëtarëve të familjes së tij, dhe se rrjedhimisht, ankesa e parashtruesit nuk mund të konsiderohej e paafatshme.
41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa e “drejtësisë” siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës mbulon procedurat në tërësi, dhe pyetja nëse një person ka pasur një gjykim “të drejtë” shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht të një incidenti të veçantë ose mangësie procedurale, ngase mangësitë e tilla në një fazë mund të

korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih, për shembull, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§55-70).

42. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e ka ndrequr Aktvendimin e Gjykatës Themelore të 15 majit 2018 përkitazi me dorëzim të parregullt të Aktvendimit të Gjykatës Themelore [E.nr.557/12] të 15 janarit 2016, që tregon se lëshimi në një instancë më të ulët është ndrequr në instancën tjetër më të lartë.
43. Për sa i përket konkluzionit për përmbarrim të Komunës së Mitrovicës, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka vërtetuar: (i) se në shkresat e lëndës ekziston fletëdorëzimi i 15 majit 2012 që dëshmon se konkluzioni i Komunës së Mitrovicës për përmbarrim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës në zyrë dhe në prezencë të punëtorëve; dhe, (ii) se konkluzioni i kontestuar i Komunës së Mitrovicës është titull përmbarrimor në pajtim me ligjin e procedurës përmbarrimore.
44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesës relevante të vendimit të Gjykatës së Apelit që përcakton: *“Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkalles se pare, ne baze te provave te cilat gjinden ne shkresat e lendes, aktvendimi E.nr.557112 te datës 15.01.2016, është i drejte dhe i bazuar ne dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qarte, prandaj konkludimin e gjykatës se shkalles se pare, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshire ne shkelje thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 te LPK-se, dhe se drejte është vërtetuar gjendja faktike, kështu qe mund te hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje te cilat gjykata e shkalles se dyte i heton sipas detyrës zyrtare ne baze te nenit 194 te LPK-se. Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi ankimor i te autorizuarit te debitorit se konkluzioni ne baze te cilit është lejuar përmbarrimi asnjëherë nuk i është dorëzuar debitorit dhe i njëjti nuk mund te jete i plotfuqishëm, është pretendim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, ngase ne shkresat e lendes ekziston flete dorëzimi nr.08-20/12 i datës 11.05.2012, me konstatimin-se konkluzioni i është dorëzuar ne zyre ne prezence te punëtorëve. Andaj, nga te cekurat kjo gjykate vlerësoj se aktvendimi i gjykatës se shkalles se pare duhet vërtetuar dhe te refuzohet ankesa e te autorizuarit te debitorit si e pathemelte [...] Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit përmbarrues, organi përmbarrues e cakton përmbarrimin vetëm në bazë të titullit përmbarrues sipas nenit 23, e në rastin konkret titull përmbarrues është konkluzioni i lëshuar nga Komuna e Mitrovicës-Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, nr. prot. 08-20/12 të datës 11.05.2012 [...] Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike [...] e që në rastin konkret kemi të bëjmë me konkluzion siç përcaktohet me dispozita ligjore.”*
45. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqiste argumente dhe dëshmi

- që ai i konsideronte relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestonte në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, mutatis mutandis, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
46. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku zakonisht njëra prej palëve në procedurë fiton dhe tjetra humb (*ibidem*, rasti Nr. KI118/17; po ashtu shih, rastin e Gjykatës Nr. KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
47. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
48. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
49. Për sa i përket kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur tek Prokurori i Shtetit, Gjykata vëren se bëhet fjalë për një mjet juridik që nuk është direkt i qasshëm për parashtruesin e kërkesës por varet nga një “palë ndërmjetëse”, e që në rastin konkret “palë ndërmjetëse” është Prokurori i Shtetit, dhe si e tillë, nuk shqyrtohet nga Gjykata (shih *Tanase kundër Moldovës*, [DHM], paragrafi 122).

50. Sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, ankesa nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
51. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 23 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

